



Pranuar / Dateduar Embleto/Prilato Received/Delivered	14.08.2023	3	viti god year
Organ / Shista Organ / Jednitsa Org / Unit	Pr. Prof. Pr. Prof. Prof No	Shitja e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	5640/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.900/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, shqyrtuar ankesën me numër A.nr.900/2023 të datës 30.06.2023 e parashtruar nga ankuesi _____, të cilin me autorizim e përfaqës _____ me adresë: _____ Rruga " _____ në Prishtinë, kundër Vendimit numër:877/2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 09.06.2023, në çështjen juridike "Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.900/2023 e datës 30.06.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër:877/2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 09.06.2023.

A r s y e t i m

Ankuesi, _____ i cili sipas shkresave të lëndës rezulton të jetë i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me datë 30.06.2023 nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar ankesë në Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil e cila është protokolluar me numër:4984/2023, kundër Vendimit numër:877/2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 09.06.2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme me rastin e zhvillimit të procedurës disiplinore, gjegjësisht shqiptimin e

masës disiplinore ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zhytarët Publik, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën e Zyrtarëve Publik, respektivisht Komisionin Disiplinor nuk ka marr për bazën nenin 7 paragrafi 1 të rregullores në fjalë lidhur me çështjen e kontestuar se kush ka të drejtë sipas ligjit material të iniciojë procedurë disiplinore ndaj nëpunësit civil, vendimi i Komisionit Disiplinor nuk është nxjerrë brenda afatit kohor prej momentit të pranimit të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, se Komisioni Disiplinor nuk ka marr për bazë nenin 85 dhe 99 të LPPA-së lidhur me pezullimin e lëndës për shkak të çështjes paraprake dhe shtyrjes së afatit të vendimmarrjes, me theks të veçantë se palës nuk mund t'i mohohet e drejtë e mbajtjes së telefonit privat gjatë orarit të punës për çështje private, veturat e parkuara në parking të institucionit punëdhënës kanë qenë në emër personal dhe jo në emër të biznesit të tij, si dhe akt i goditur përmes kësaj ankese është kundërshtim me nenin 52 paragrafi 1.3 dhe 1.5 të LPPA-së ndërlidhur me nenin 48 paragrafi 2 i të njëjtit ligj për shkak të shkeljeve të ligjit material dhe shkeljes së dispozitave të procedurës administrative dhe arsytimit të pamjaftueshëm, paqartë apo kundërthënës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 06.07.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Punëve të Brendshme. Këshilli me datë 25.07.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 30.06.2023 me numër protokolli 4984/2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Autorizimin e datës 11.04.2023; Çertifikatën e regjistrimit të biznesit të datës 14.10.2020; Vërtetimin e Policisë për sekuestrimin e sendeve; Akt emërimit e ankuesit të datës 31.05.2018; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 12.05.2023; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 18.04.2023; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 18.05.2023; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 09.06.2023 me nmër:877/2023; Katër (4) kartelat e Regjistrimit të automjeteve të ankuesit; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 18.04.2023; E-mailin e datës 23.06.2023 dërguar nga Personeli MPB për përfaqësuesin e ankuesit; Bisedat e zhvilluar nga ankuesi përmes aplikacioneve të rrjeteve sociale; Kontrata mbi qiramarrjen e veturës së ankuesit; Fotot të ankuesit dhe veturave të ndryshme; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.07.2023; Përgjigjen në kërkesë e datës 25.07.2023; Vendimin për themelimin e Komisionit Disiplinor i datës 17.11.2021; Akt emërimit e ankuesit të datës 15.07.2020; Akt emërimit e datës 24.06.2013; Akt emërimit e datës 11.01.2013; E-mailin e datës 17.05.2023 dërguar nga përfaqësuesi i ankuesit për Njësinë e Burimeve Njerëzore të MPB-së me korrespondencën e bashkangjitur prej pesë (5) faqesh; E-mailin e datës 23.05.2023 dërguar nga Personeli MPB për ankuesin; E-mailin e datës 11.05.2023 dërguar nga Personeli MPB për ankuesin; Njoftimin me Ftesën e datës 11.05.2023; E-mailin e datës 12.05.2023 dërguar nga personeli MPB për ankuesin; E-mailin e datës 17.05.2023 dërguar nga Personeli MPB për anëtarët e Komisionit Disiplinor; E-mailin e datës 18.05.2023 dërguar nga Personeli MPB për ankuesin; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 25.05.2023; E-mailin e datës 18.05.2023 dërguar nga Personeli MPB për Sh.N; Procesverbalin e datës 18.05.2023 të seancës së Komisionit Disiplinor; Procesverbalin e datës 15.05.2023 të seancës së Komisionit Disiplinor; E-mailin e datës 13.06.2023 dërguar nga Personeli MPB për ankuesin me tre (3) procesverbalet e bashkangjitura; Formularin e vlerësimeve të rezultateve në punë i datës 28.01.2022; Formularin e vlerësimeve të rezultateve në punë i datës 31.01.2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga shqyrtimi shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankuesi sipas Akt të Emërimit të datës 31.05.2018 me Nr.prot:268/2018 është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në pozitën "Zyrtar i Lartë për Monitorimin e Transportit Qeveritar", ndërsa me datë 18.04.2023 Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme (tani e tutje MPB-së) përmes kërkesës me numër:513/2023 ka kërkuar prej Komisionit Disiplinor inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me pretendimin se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuara me dispozitat e nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafit 3.7, 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik për shkak se ankuesi e ka shfrytëzuar parkingun e MPB-së për përfitime personale dhe pa autorizim; mos respektimit të orarit të punës për kryerjen e detyrave të tij të punës dhe shfrytëzimit të hapësirave të punës në MPB për aktivitete private dhe lejimi i qasjes së personave të paautorizuar.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, pas zhvillimit të procedurës disiplinore ka nxjerrë Vendimin Nr.877/2023 të datës 09.06.2023 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Largim në Shërbimin Civil" e përcaktuar me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik me arsyetimin se e ka gjetur përgjegjës për shkeljet të rënda disiplinore të dispozitave të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafit 3.7, 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 3 Shkelje të rënda konsiderohen: 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi" për shkak se ankuesi gjatë orarit zyrtarë të punës dhe brenda hapësirave të identifikuara në pronësi apo shfrytëzim nga institucioni punëdhënës, vizavi parkingu zyrtar në kuadër të MPB-së, më saktësisht me datë 03, 04 dhe 05 prill 2023 sipas audio/video incizimeve të realizuara nga emisioni "B-D" rezulton se ankuesi kishte kryer veprime afariste-biznesore apo dhënie të veturave të tij për shfrytëzim me qira "rent a car" zyrtarëve të këtij emisioni të cilët ishin paraqitur në cilësi të klientëve të interesuar për marrjen e veturave në shfrytëzim nga ankuesi.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me shkeljet procedurale dhe materiale ka analizuar dispozitat e nenit 48 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.2. me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, si dhe me kërkesën e qytetarit" dhe ka ardhur në përfundimin se pretendimi ankimor i ankuesit se Sekretarja e Përgjithshme e MPB-së nuk është udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankuesit dhe nuk ka të drejtë të iniciojë procedurë disiplinore ndaj të njëjtit është pretendim i pabazuar, ngase përkrahimi i dispozitës së lartcekur është mjaft i qartë, ngase Sekretarja e Përgjithshme e MPB-së është zyrtari më i lartë administrativ në kuadër të institucionit dhe ka detyra apo kompetenca të

kontrollit hierarkik lidhur me funksionim e gjithmbarshëm të institucionit ndaj secilit nëpunës civil, e në rastin konkret edhe andaj ankuesit.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 85 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit"* dhe ka ardhur në përfundim se pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me moszbatimin e nenit 85 paragrafi 1 të LPPA-së është shkelje procedurale ngase për të njëjtin rast ndaj ankuesit është hapur proces gjyqësorë është pretendim i pa bazuar, ngase në rrethanat e rastit konkret çështja paraprake nuk ndërlidhet me kompetencën apo me natyrën e hetimit/ndjekës, madje dispozitat e ligjit material me asnjë nen nuk ia ndalojnë Komisionit Disiplinor të zhvillojë procedurë disiplinore për shkelje të detyrave të punës në kuadër të Shërbimit Civil, nëse për rrethanat e të njëjtit rast ekziston dyshimi i bazuar se shkelja mund të ketë edhe elemente të veprës penale, prandaj nga ajo që u tha si më lartë Komisioni Disiplinor ka vepruar në pajtueshmëri me kompetencat e përcaktuara si në nenin 48 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa çështja e zhvillimit të procedurës disiplinore dhe shqiptimit të masave eventuale disiplinore në Shërbimin Civil sipas ligjit material është proces i ndarë nga zhvillimi i procedurës në instanca gjyqësore të natyrës penale, andaj në rrethanat e rastit konkret sikurse pretendon ankuesi "çështja paraprake" nuk gjen zbatim ngase jo domosdoshmërisht duhet të shpallet fajtor në instanca gjyqësore për t'i hapur rrugë zhvillimit të procedurës disiplinore apo shqiptimit të masave disiplinore të përcaktuara me ligjin material për nëpunësit e Shërbimit Civil.

Lidhur me pretendimin ankuesit se Komisionin Disiplinor vendimin e kontestuar përmes kësaj ankese e ka nxjerrë jashtë afatit ligjor sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 12 paragrafi 6 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën e Zyrtarëve Publik, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 12 paragrafi 3 dhe 4 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *"4. Seanat e Komisionit disiplinor janë të mbyllura përpos nëse parashihet ndryshe me Ligjin në fuqi dhe mbahen me praninë fizike të të gjithë anëtarëve siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. 5. Vendimi në komision disiplinor merret siç përcaktohet në dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative"*, ndërlidhur me nenin 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 99 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"1.Ky ligj zbatohet në çdo rast kur një organ publik në realizimin e autoritetit publik: 1.1. vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ; dhe 99.1. Përveç kur ndalohet shprehimisht me ligji, nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, organi publik mund të shtyjë, vetëm një herë, afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative, sipas nenit 98 të këtij Ligji"* dhe ka ardhur në përfundimin se meqenëse dispozitat e ligjit të veçantë në rrethanat e rastit konkret ligji material respektivisht Rregullorja Nr.11/2020 për Disiplinën e Zyrtarëve Publik nuk e ka ndaluar shtyrjen e afatit të procedurës së vendimmarrjes por vetëm e ka caktuar afatin vendimmarrës, madje nenin 12 paragrafi 3 dhe 4 e obligojnë Komisionin Disiplinor që të veprojë në pajtueshmëri me dispozitat e LPPA-së, atëherë pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar, për arsye se me datë 18.04.2023 Sekretarja e Përgjithshme e MPB-së e ka iniciuar procedurën disiplinore, ndërsa Komisioni Disiplinor me datë 18.05.2023 ka nxjerrë Vendimin Nr.705/2023 për shtyrjen e afatit fillestar edhe për tridhjetë (30) ditë të tjera kalendarike,

madje ky vendim është si rezultat i pretendimeve të ngritura nga pala ankuese në seancën disiplinore të mbajtur pranë Komisionit Disiplinor të datës 18.05.2023 me kërkesën që procedura disiplinore duhet të pezullohet në tërsi për shkak të rrethanave të përcaktuara me dispozitat e nenit 85 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit veprimi i Komisionit Disiplinor ka qenë në përputhje me dispozitat dhe frymën e LPPA-së sa i përket të drejtës për shtyrje të afatit fillestar, ngase kjo kërkesë nga pala ankuesi ishte shtruar ditën e fundit të vendimmarrjes e për rrjedhojë Komisionit Disiplinor i është dashur kohë që të shqyrtojë nëse kërkesa që të pezullohet procedura disiplinore sipas nenit 85 të LPPA është e ligjshme, prandaj nga se u tha si më lartë Kolegji i Këshillit konstaton se ky pretendim ankimor i palës ankuese është i pabazuar, madje ngase nga shkresat e lëndës nuk rezulton se kjo shtyrje e afatit ta ketë rënduar apo përkeqësuar gjendjen juridike të palës në procedurë.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit për shkelje materiale nga ana e Komisionit Disiplinor të MPB-së, ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik neni 4 paragrafi 1 dhe 2 si dhe nenin 9 paragrafi 1, 5 dhe 6 ku përcaktohet se: "4.1 Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës zyrtari publik kryen punë ose shërbime në të mirë të institucioni. 4.2. Orari i punës së zyrtarëve publik fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00, pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten, përveç nëse caktohet ndryshe nga institucioni përkatës për shkak të natyrës së punës; dhe 9.1 Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë prezent në vendin e punës. Mos respektimi i orarit të punës, sipas Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik paraqet shkelje disiplinore; Për çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, zyrtari publik duhet të marrë leje të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt" ndërlikur me nenin 25 paragrafi 1, 2 dhe 3 si dhe nenin 27 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "25.1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut; 25.2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës; 25.3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike, dhe 27.1. Zyrtari publik është i obliguar të menaxhojë me kujdes pasurinë shtetërore, që i vihet në detyrim për ushtrimin e detyrës dhe të përdorë atë vetëm për qëllimin e përcaktuar me ligj dhe sipas rregullave të brendshme të institucionit. 27.2. Zyrtarit publik nuk i lejohet të shfrytëzojë pasurinë shtetërore si mjet për zhvillimin e veprimtarisë personale ekonomike ose të aktiviteteve të paligjshme. 27.3. Zyrtari publik është i detyruar të shfrytëzojë orarin e punës me efikasitet dhe vetëm për kryerjen e detyrave të tij të punës" dhe ka ardhur në përfundimin se nëpunësi civil gjatë orarit zyrtar të punës, duhet të kujdeset vetëm për përfundimin dhe kryerjen e detyrave të punës të cilat dalim si obligim nga pranimi i kushteve dhe rregullave të punës me rastin e nënshkrimit të Aktit të Emërimit, për aq kohë sa nuk kërkohen edhe detyrave shtesë nga mbikëqyrësit në pajtueshmëri me parimet e përgjithshme të përcaktuara me ligjin material, orarin e përcaktuar zyrtar të punës duhet të shfrytëzojë vetëm për përmbushjen e detyrave funksionale, duke u kujdesur që asetet shtetërore duhet të shfrytëzohen vetëm për qëllim të përmbushjes së detyrave të punës dhe jo për qëllime të përfitimeve ekonomike apo personale, ndërsa në të kundërtën mban përgjegjësi sipas dispozitave të nenit 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij."

Nga se u tha si më lartë dhe bazuar në shqyrtimin e provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshilli ka arritur në përfundimin se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" ndaj ankuesit, ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat e materiale dhe procedurale, ngase sipas shkresave të lëndës dhe deklarimeve të ankuesit në seancën disiplinore të datës 25.05.2023 pranë Komisionit Disiplinor, konstatohet fakti se ankuesi gjatë orarit të punës me datë 03.04.2023 kishte realizuar telefonata me qëllim të dhënies në shfrytëzim të veturave të tij me qira apo "rent a car", madje personave të njëjtë ua ka prezantuar veturat e tij të cilat i ka mbajtur të parkuara në hapësirat e parkingut zyrtar të institucionit punëdhënës, po ashtu me datë 04.04.2023 ankuesi gjatë orarit zyrtar i kthehet vetura e tipit Polo me targa 01-386-SK nga personi i cili e kishte marr me qira nga ankuesi këtë veturë me datë 03.04.2023, sikurse edhe me datë 05.04.2023 ankuesi serish realizon telefonata me persona të interesuar për qiradhënie të veturave dhe po në të njëjtën ditë brenda orarit zyrtar të punës takohet jashtë vendit të punës me personat në fjalë ndërsa më pastaj ua prezanton veturën e BMË X e parkuar në hapësirat e parkingut zyrtar të institucionit punëdhënës, dhe po ashtu nga konstatohet fakti se ankuesi ditën e datës 05.04.2023 në hapësirat e parkingut zyrtar të institucionit punëdhënës kishte pasur të parkuara dy (2) vetura.

Lidhur me provat e lëndë dhe pretendimet e palës ankuesi të parashtruara në ankesën e datës 30.06.2023 pranë Këshillit nga ankuesi, sikurse Certifikata e regjistrimit të biznesit "Riza Renta Car" me numër identifikues:811466003 si dhe pretendimi se veturat e dhëna në shfrytëzim nuk kanë qenë vetura të regjistruara në emër të biznesit por në emrin personal të ankuesit me arsyetimin se ankuesi ka të drejtë të mbajë një veturë të parkuar në hapësirat e parkingut zyrtar të institucionit punëdhënës më theksin se i njëjti disa herë ka punuar edhe jashtë orarit zyrtar të punës me qëllim të përfundimit të detyrave të punës dhe asnjëherë nuk kishte kërkuar kompensim me relevanten se largimi nga vendi i punës për disa minuta nuk e ka dëmtuar institucionin punëdhënës duke kontestuar ngjarjen e datës 03, 04 dhe 05 prill 2023 me arsyetimin se personat e prezantuar si klient të interesuar realisht kanë qenë gazetar nga emisionin "Betimi për Drejtësi" dhe e gjithë ngjarja ka qenë e montuar, andaj lidhur me të njëjtat Kolegji i Këshillit thekson faktin se në rrethanat e rastin konkret që të gjitha janë argumente të paqëndrueshme, ngase çështja e regjistrimit të aktiviteteve biznesore nuk hynë në fushëveprimin dhe mandatin e Këshillit dhe madje as çështja se konstatimi i ngjarjes është bërë nga emisionin i cili ka qenë emision i prezantuar publik nga "Betimi për Drejtësi", pasi që e rëndësishme është se nga e gjithë rrjedhoja e ngjarjes sikurse në datat respektive konstatohet fakti se ankuesi me vullnet të lirë dhe pa presion gjatë orarit zyrtar të punës ka kryer veprime të afarizmit apo aktiviteteve ekonomike me qëllim të përfitimit personal, madje veturat e dhëna në shfrytëzim i ka mbajtur në hapësirat e parkingut zyrtar të institucionit punëdhënës, sikurse nuk është i rëndësishëm as pretendimi i palës ankuesi se veturat e mbajtura në parkingun zyrtar nuk janë të regjistruara në emrin e biznesit por në emrin personal të ankuesit, madje një pretendim i tillë është kundërtë në pasiqi që edhe biznesi është pronë e ankuesit sikurse që edhe veturat e dhëna apo prezantuar për dhënie në shfrytëzim janë pronë e ankuesit.

Prandaj, ngase u tha si më lartë nga konstatimi i gjendjes faktike dhe analizimit të shkresave të lëndës është konstatuar fakti se ankuesi ka shkelur detyrimet e përcaktuara me dispozitat e nenit 25, 27 dhe 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe me veprimet e tij të pasqyruara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi i njëjti ka konsumuar elementet e përgjegjësisë disiplinore të

përcaktuare me nenin 45 të të njëjtit ligj: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmi", dhe për çka i njëjti mbahet përgjegjës për shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.7, 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për zyrtarët Publik, ndërsa masa e shqiptuar disiplinore është në raport të drejtë me shkeljen e kryer për shkak të rrethanave të kryerjes së shkeljes (veprimeve të kryera gjatë orarit zyrtar për përfitime personale nga biznesi i tij privat, madje me vetura të parkuara brenda hapësirave të parkingut zyrtar të institucionit punëdhënës) duke shkelur kështu detyrimet e përcaktuara sipas nenit 25, 27 dhe 28 të Ligjit për Zyrtar Publik.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të provave të ofruara nga palët në procedurë si dhe na bazë të të gjeturave me shkeljet e evidentuara të theksuara si më lartë në këtë vendim, ka konstatuar se Vendimi numër:877/2023 i datës 09.06.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme është në pajtueshmëri 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme dhe si i tillë ka mbetur në fuqi, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, prandaj ankesa e ankuesit e datës 30.06.2023 është refuzuar në tërësi sikurse në dispozitiv e këtij vendimi

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 81 paragrafi 4 dhe nenin 132 paragrafi 2 dhe të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.900/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme ;
- Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Arkivoit të KPMSHCK-së